

Të nderuar qytetarë,

Qeveria aktuale ka një përmasë të padiskutueshme hyjnore! Mjaftoni të shikoni Kryeministrin sipër, që na sheh atërisht, ëmbëlsisht, dhe na kujton ditën e gjykimit si Jezusi në Galile. I bjerrë në besim dhe qorr dy sysh ai që nuk e sheh apo ndien. Mesia dhe dishepujt nuk administrojnë, por ata shpallin të vërtetat solemne të jetës sonë të përditshme! Falë tyre Shqipëria buzëqesh dhe nuk zgërdhiet. Falë tyre mbin bari, falë tyre ujkun s'e ha gomari. Falë tyre ngroh dielli, falë tyre nuk rrëzohet qielli, falë tyre mblidhet edhe ky parlament. Falë tyre hapet universiteti në datën 18 tetor. Cila qeveri në botë ia del t'u japë kaq gëzime e sihariqe qytetarëve të vet, që të pamundurën ta bëjë të mundur si kjo e jona? Sillen kështu se janë të mirë, të dëlirë, me besë e shpresë.

Pandemia vërtet që trazim i madh për botën, gazepi vetë, por ne e luftuam që në fillim virusin me autoblanda e mitraloza. Sa herë kujtoj atë fakt, me ngjan se ministrja Manastirliu hipur mbi tank, nën vështimin e mallëngjyer të liderit për heronjtë e vet, hedh bume dhe vret pa frikë 300 apo 400 viruse të tërbuar, që kishin marrë rrugën për Surrel. Me kaq kalojmë nga përkëdhelja në realitet. Shkolla parauniversitare filloi plot rrëmujë, kakofoni, ndoca gënjeshtër si për lezet kundër syrit të keq, protesta kundër qeverisë e lutje drejtuar Zotit nga prindërit. Një javë me turne, pastaj të gjithë bashkë, se virusi u fsheh për ca ditë. Mësuesit e Tiranës, të shtunë e të diel nxirren në punë me urdhër të drejtoreshës, urdhër të cilin ua dërgon me SMS në darkë, me porosinë: kujdes, se jeni në fokus.

Tani po presim fillimin e mësimit në universitet. Studentët shqiptarë, deri tani janë shumë pak të vaksinuar, në një shoqëri shumë pak të vaksinuar, një pjesë e të cilëve edhe me vakcina të dyshimta. Si pedagog i disave prej tyre, shfrytëzoj këtë foltore të nderuar, për t'u bërë thirrje: Vaksinohuni, vaksinohuni, vaksinohuni, si mënyra më e mirë për t'u mbrojtur nga Covid - 19! Kjo fushatë nuk mund të niste vetëm një javë para se të fillonte shkolla. Së paku duhej të niste në korrik, dhe jo me kërcënime, por me sensibilizim, ndonëse kërcënimi është gjuha që njeh Kryeministri. Koha ndërmjet kësaj ndërmarrjeje dhe fillimit të procesit është e pakët, ndonëse infektimet dhe vdekjet janë ende shumë të larta. Për rrjedhojë, risku është shumë i lartë. Kush do t'i kontrollojë studentët ditë për ditë? Pedagogët do të sillen si infermierë apo rojet e fakulteteve? Do të ketë shumë kontroll e pak mësim, apo pak mësim e shumë kontroll? Sa kohë do t'i mbetet mësimit? Në auditorët tona studentet rrinë ngjeshur si sardelet, për fat të keq. Ambientet dhe tualetet janë ato të para shtatëdhjetë vjetëve. Higjiena sigurisht që ka pjesën e vet. Si do të vepohet nëse sëmuren disa studentë? Do të mbyllet grupi, do të mbyllet kursi? Çfarë do të ndodhë? A ka ambiente alternative dhe mundësi për distancim fizik? Përgjigjja është e thjeshtë: zero. Sa lek ka vënë në dispozicion kjo qeveri për emergjencat shëndetësore për studentët? Kush do t'ua paguajë atyre testet? Sa teste do të bëjnë? Pra, në horizont mbretëron rrëmuja. Zoti Kryeministër i munguar, Zotërinj të qeverisë, prezentë, por të munguar, Një tjetër shqetësim është shfaqur këto ditë në lidhje me kulturën dhe dijen në Shqipëri. Ka një tentativë për të asgjësuar Qendrën Albanologjike, me kërkesë të Skënder Gjinushit, i cili i kërkon ndihmë zotit Agaçi, që të përgatisë një projektvendim. Me gjasë, arsyeja është një tjetër nga ajo që paraqitet, sepse i keni dhënë goxha lekë për historinë, enciklopedinë, fjalorin, dhe ai s'ka si i bën, s'ka me kë i bën, ndaj i duhen punëtorët shkencorë në varësi dhe institutet. Zoti Kryeministër, Është dukuri shtetshkaterruese, që sa herë ndërron pushteti në këtë vend, të bëhen eksperimente kriminale në kurriz të dijes, të albanologjisë dhe të kulturës kombëtare, ndaj ju bëj thirrje juve, ministres Kushi dhe

deputetëve në këtë sallë: Të mbrohet autonomia e Qendrës Albanologjike dhe e të gjitha institucioneve që operojnë brenda ligjit të Arsimit të Lartë. Të ndërpriten presionet e dirigjuara nga drejtuesit politikë të administratës së Akademisë së Shkencave kundër kësaj qendre. Te respektohen vendimet e Senatit dhe Këshillit të Profesorëve për mbrojtjen e autonomisë së Qendrës Albanologjike. Nëse vërtet dëshironi të bëni një gjest purifikues, kërkojuni që ta lënë Akademinë dhe institucionet e tjera të gjithë spiunët e ishSigurimit të Shtetit, inicialet e të cilëve i botoi dje një gazetë pro qeverisë, disa prej tyre në Akademi. E kuptoj nostalgjinë e enveristëve dhe të ramizistëve për të marrë çfarë u la Enveri, dhe ndaj tyre një vaksinë dekomunistizimi, që Shqipëria në tridhjetë vjet liri s'e prodhoi dot, ndoshta me moton: Akademia buzëqesh, Gjinushi serbes. Faleminderit!